



ODA E MJEKËVE TË KOSOVËS
KOSOVO DOCTORS CHAMBER • LEKARSKA KOMORA KOSOVA

Oda e Mjekëve të Kosovës



Raport i Punës për tremujorin e tretë

Korrik - Shtator, 2025

Prishtinë, Tetor 2025

Ky raport paraqet punën e OMK-së për periudhën Korrik-Shtator të vitit 2025.

Raporti përmbledhë aktivitetet e të gjitha njësive organizative të OMK-së, duke u koncentruar në fushat kryesore, të cilat përbëjnë objektivat e punës së Odës.

Përmbajtja:

1. Këshilli Drejtues.....	4
2. Këshilli Mbikqyrës	4
3. Anëtarësimi	5
4. Mbikëqyrja etiko-profesionale	6
5. Edukimi i Vazhdueshëm Profesional	7
6. Licencimet	8
7. Komisioni për Çështje Etike	8
8. Komisioni për Solidaritet dhe Ndihmë Reciproke	8
9. Raporti financiar.....	9
9.1 Raporti financiar për periudhën Korrik-Shtator 2025.....	9
9.2 Prokurimi	9
10 Aktivitete të tjera	10
11.1 Kongresi i VII të Mjekësisë.....	10
11.2 Revsita Mjeku - Obeziteti dhe (KEQ) Ushqyerja	11
11.3 Bashkëpunimi profesional	
12 Plani i veprimit për 2025.....	12

1. Këshilli Drejtues

Këshilli Drejtues ka mbajtur dy takime, lëndët e shqyrtuara janë si më poshtë:

Organi	Numri i lëndëve të pranuar për periudhën korrik - shtator	Vendimet /Përgjigjet sipas kërkesave /ankesave të pranuar për periudhën korrik - shtator	Vendimet në procedurë	Vendimet e Këshillit Drejtues për periudhën korrik - shtator	Vendime/Përgjigje për lëndët e bartura nga periudhat paraprake
Këshilli Drejtues i Odës	11	7	4	-Vendim për fillim të procedurës së prokurimit për furnizim me fakslimila; -Vendim për aprovim të kërkesës për trajnimin e ultrazërit diagnostik të sistemit osteomuskular; -Vendim për aprovim të kërkesës për fillimin e procedurave të prokurimit për auditor; -Vendim për aprovim të raportit të punës së OMK-së për tre mujorin e dytë të vitit 2025.	2

Katër vendime në procedurë janë për faktin se janë pranuar pas mbajtjes së mbledhjes së fundit të Këshillit Drejtues në muajin Shtator dhe pritet të shqyrtohen në mbledhjen e parë të muajit Tetor 2025.

Gjithashtu dy kërkesat e tre mujorit të dytë janë të vendosura në numrin e lëndëve të bartura për këtë tre mujor si dhe janë marrë vendime në periudhën korrik-shtator.


2. Këshilli Mbikqyrës

Gjatë kësaj periudhe, Këshilli Mbikëqyrës i Odës së Mjekëve të Kosovës ka zhvilluar pesë takime, ku janë shqyrtuar çështje të rëndësishme për funksionimin e rregullt dhe transparent të institucionit. Në këto takime, Këshilli ka analizuar Raportin e Punës për tremujorin e dytë të vitit 2025, Vendimet e Këshillit drejtues si dhe të organeve tjera të OMK-së.


Brenda kësaj periudhe është adresuar edhe një kërkesë zyrtare, për të cilën Këshilli ka hartuar dhe përcjellë një rekomandim përkatës, në përputhje me kompetencat dhe përgjegjësitë që i takojnë këtij organi mbikëqyrës.

3. Anëtarësimi

Në Odën e Mjekëve të Kosovës u anëtarësuan 57 mjekë, 10 mjekë të punësuar në sektorin privat, 7 mjekë të punësuar në sektorin publik dhe 40 mjekë të papunë.



Grafikoni: Anëtarësimet për periudhën kohore Korrik – Shtator 2025



Grafikoni: Totali i përgjithshëm i anëtarëve deri më datën 30 Shtator 2025

Gjatë kësaj periudhe janë rianëtarësuar 8 mjekë, janë ç'anëtarësuar 144 mjekë dhe kanë vdekur 4 mjekë, si rezultat numri total i anëtarëve deri me datën 30 Shtator është 5544 mjekë.

4. Mbikëqyrja etiko-profesionale

Për ta pasqyruar ecurinë e Mbikëqyrjes Etike dhe Profesionale, Prokurorit të odës, Gjyqit të Nderit dhe certifikatave të kaluara etike dhe profesionale, do të paraqesim në mënyrë tabelare.

Organi	Lëndët e bartura nga periudhat paraprake	Numri i lëndëve të pranuar për periudhën Korrik - Shtator	Vendimet sipas procedurës së zhvilluar për periudhën Korrik - Shtator	Sanksionet e shqiptuara për periudhën Korrik - Shtator	Sanksionet e ekzekutuara për periudhën Korrik - Shtator	Lëndët në shqyrtim
Prokurori i Odës	25	28	22	N/A	N/A	31
Këshilli Etik	18	26	14	Rekomandim kolegjial 3 Qortim Publik 1	Rekomandim kolegjial 2	30


Gjyqi i Nderit	1	2	3	///	///	0
Certifikatat e kaluarës etike	///	235	///	///	///	///

Gjatë ketij tre mujori janë lëshuar 235 certifikata për të kaluarën etike dhe profesionale. 217 certifikata janë lëshuar për mjekët që kanë marrë certifikata për shtesa mbi pagë në sektorin publik Rregullorj nr. 02/2023, dhe mjekët që kanë marrë certifikata edhe viteve të kaluara. Ndërsa, 18 mjekë kanë kërkuar për herë të parë të ju lëshohet certifikata mbi të kaluarën etike dhe profesionale, këto kërkesa janë realizuar dhe mjekët janë pajisur me certifikata për përdorim jashtë territorit të Republikës së Kosovës

5. Edukimi i Vazhdueshëm Profesional


Komisioni ka akredituar gjithsej 10 aktivitete, prej të cilave 2 aktivitete janë realizuar me taksë administrative.

Gjithashtu, është marrë vendim për refuzimin e një lënde për akreditimin e aktivitetit, për shkak të mosplotësimit të kriterëve përkatëse, në përputhje me rregulloren përkatëse.



6. Licencimet

Komisioni për Licencim dhe Rilicencim profesional, ka lëshuar gjithësej 224 licenca me kategoritë si në grafikun e mëposhtëm:



7. Komisioni për Çështje Etike

Komisioni për Çështje Etike ka pranuar 19 kërkesa për leje-hulumtim, 1 kërkesë për leje-hulumtim ka qenë e bartur nga tremujori i kaluar si dhe ka pranuar 9 kërkesa për raport përmbyllës.

KÇE për 20 kërkesa të shqyrtuara ka nxjerr 16 Vendime aprovuese, dhe 3 kërkesa kanë kaluar për shqyrtim në periudhën vijuese, 1 kërkesë është refuzuar. KÇE për 11 raporte përmbyllëse të shqyrtuara ka nxjerr 11 Vendime aprovuse, 9 të pranuar gjatë këtij tre mujori si dhe 2 kërkesa kanë qenë të bartura nga peridha paraprake.

8. Komisioni për Solidaritet dhe Ndihmë Reciproke

Komisioni për Solidaritet dhe Ndihmë Reciproke ka pranuar 3 kërkesa për përkrahje financiare. Nga këto, komisioni ka aprovuar 3 kërkesa të cilat i përkasin kësaj periudhe të raportimit si dhe 1 kërkesë është aprovuar, e cila ka qenë e bartur nga peridha paraprake.

9. Raporti financiar

9.1. Raporti financiar për periudhën Korrik-Shtator 2025

RAPORTI FINANCIAR DERI ME 30 SHTATOR 2025				
1.0 Të hyrat:				
1.1 Paraja në bankë me 31.12.2024	€	843,465		
Total Paraja në bankë me 31.12.2024				€ 843,465
1.2 Të hyrat	Realizimi: TM1	Realizimi: TM2	Realizimi: TM3	TOTAL
1.2.1 Të hyrat nga anëtarësia:				
1.2.1.1 Anëtarësimi i mjekëve shtetas kosovarë	€	342,715	€ 154,559	€ 3,000
1.2.1.2 Anëtarësimi i mjekëve shtetas jo kosovarë	€	1,800	€ 3,100	€ 26,440.00
1.2.2 Licencimi	€	13,647	€ 12,700	€ 10,625
1.2.3 Të hyrat e tjera*	€	11,709	€ 12,986	€ 27,248
Të hyrat deri me 30.09.2025	€	369,871	€ 183,345	€ 67,313
Paraja në bankë me 31.12.2024				€ 843,465
TOTAL TË HYRAT				€ 1,463,994
2.0 SHPENZIMET	Shpenzimet: TM1	Shpenzimet: TM2	Shpenzimet: TM3	TOTAL
2.1 Paga, medijtje dhe kontributet pensionale	€	84,791	€ 66,799	€ 74,853
2.2 Material shpenzues	€	518	€ 1,694	€ 639
2.3 Reprezentacioni	€	846	€ 756	€ 778
2.4 Edukimi i vazhdueshëm profesional	€	52,796	€ 8,480	€ 37,453
2.5 Shpenzimet e tjera*	€	7,598	€ 10,638	€ 5,325
2.6 Shpenzimet e aseteve			€	2,940
2.7 Përkrahje financiare në kuadër të fondit për solidaritet	€	8,450	€ 5,150	€ 25,400
2.8 Llogari të Pagushme (Obligim i bartur-Meditje dhe tatime)			€	7,976
Shpenzimet deri me 30.09.2025	€	154,999	€ 101,492	€ 147,388
Neto të hyrat për TM3 2025				€ 216,650
TOTAL BILANCI 30.09.2025				€ 1,060,115

1.2.3 * Faksimili, Faksimili i dytë, Certifikata për të kaluarën etike profesionale, Taksa për paraqitjen e provimit, Kongreset, simpoziumet, seminarët, Lejimi për hulumtime për persona juridik, Të ardhurat të tjera.

2.5* Faksimili, Shpenzimet për botimin e revistës, Shpenzimet e ID kartelave të Odë, Shpenzime të përkthimeve/lektorimit, Meditje për udhëtime zyrtare, Mirembajtja e softverit për financa, Shpenzimet e tel., Shpenzimet e int., Shpenzimet e postës, Shpenzime bankare, Shpenzimet e pastrimit, Shpenzimet e transportit, Shpenzimet e tjera operative.

9.2 Prokurimi

Gjatë kësaj periudhe janë zhvilluar 3 procedura të prokurimit, 1 procedurë të hapur me vlerë të madhe të prokurimit, si dhe 2 procedura me vlerë të vogël të prokurimit.

Në muajin korrik janë zhvilluar dy (2) procedura me vlerë të vogël të prokurimit për furnizim me paisje të teknologjisë informative si dhe procedura për shërbime të avokatisë/përfaqësim dhe këshillim ligjor. Gjithashtu, në muajin Gusht u zhvillua një procedurë të hapur me vlerë të madhe për furnizim me faksimila. Procedurat e prokurimit u zhvilluan me sukses dhe brenda afatit janë lidh kontratat me operatorët ekonomik.

10 Aktivitete të tjera

11.1 Kongresi i VII të Mjekësisë

Këshilli Organizativ dhe Këshilli Shkencor kanë zhvilluar një sërë takimesh për koordinimin e punëve lidhur me organizimin logjistik dhe përgatitjet shkencore të Kongresit. Deri më tani është arritur një progres i dukshëm në të gjitha drejtimet.

Përgatitjet logjistike dhe administrative:

- Është realizuar komunikimi me ligjëruesit e ftuar dhe janë bërë konfirmimet për pjesëmarrje.
- Janë përfunduar blerjet e biletave dhe aranzhimet e akomodimit për mysafirët.
- Brenda më pak se 72 orëve pas hapjes së regjistrimeve janë regjistruar 2000 pjesëmarrës pasivë, çka tregon një interesim të jashtëzakonshëm për Kongresin.

Aspekti shkencor dhe akademik:

- Janë përfshirë rreth 250 autorë dhe bashkautorë të temave që do të prezantohen gjatë Kongresit.
- Deri më tani janë pranuar 57 abstrakte nga autorë vendorë:
 - 29 prej tyre janë përzgjedhur për poster-prezantime;
 - 28 për prezantime orale.

Është duke u finalizuar programi shkencor i Kongresit me pjesëmarrjen e 44 ligjëruesve të ftuar nga rajoni, Evropa dhe Azia.

Aktivitete plotësuese:

Po organizohet një workshop profesional “Pediatric Perioperative Life Support (PPLS)”, me qëllim ngritjen e kapaciteteve të anesteziologëve në fushën pediatrike perioperative.

Përgatitjet për Kongresin janë në fazë të avancuar dhe po zhvillohen sipas planit të veprimit. Pjesëmarrja e lartë, interesimi i madh nga profesionistët vendorë e ndërkombëtarë dhe cilësia e përmbajtjes shkencore pritet të bëjnë këtë ngjarje një prej kongreseve më të rëndësishme profesionale në vend.

11.2 Revsita Mjeku - Obeziteti dhe (KEQ) Ushqyerja

Ky numër është publikuar gjatë muajit Shtator 2025 dhe përbëhet gjithsej prej 39 artikujve të përmbledhur në 135 faqe. Artikujt trajtojnë temën e Obezitetit dhe kequshqyerjes nga profesionistët shëndetësorë të fushës adekuate mjekësore.

“Obeziteti dhe (Keq)ushqyerja” është publikuar në faqen zyrtare të facebookut dhe Web-faqen e OMK-së ku mund të shikohet nga publiku i gjerë

<https://omk-rks.org/wp-content/uploads/Revista-Mjeku-Vellimi-5-Numer-3-Obeziteti-dhe-kequshqyerja.pdf>.

11.3 Bashkëpunimi profesional

Në kuadër të kompetencës publike lidhur me mbikëqyrjen e veprimtarisë profesionale të mjekëve, Kryetari i OMK-së duke u bazuar në kompetencat ligjore sipas Ligjit për OPSH-të, në bazë të kërkesave nga Këshilli Etik i OMK-së, Prokurori i OMK-së, Gjykatat Themelore ka caktuar ekspert apo grupe të ekspertëve lidhur me konstatimin e përgjegjësisë profesionale mbi zbatimin e procedurave mjekësore nga mjekët gjegjës.

Organi	Numri i lëndëve të pranuar për periudhën korrik - shtator	Vendimet sipas urdhëresave/kërkesave të pranuar për periudhën korrik - shtator	Në procedurë	Raportet e ekspertizave të përfunduara për periudhën korrik - shtator	Vendime për lëndët e bartura nga periudhat paraprake
Kryetari i Odës	3	3	0	0	0

Në këtë periudhë kohore katër lëndët e pranuar nga Gjykatat dhe Prokuroritë janë kthyer prapa me arsyetimin sepse nuk është duke u ekzekutuar asnjë pagesa e ekspertëve të caktuar nga Oda e Mjekëve dhe një kërkesë është nga Prokurori i Odës që vendimi për themelimin të Komisionit është bërë në muajin korrik 2025.

12 Plani i veprimit për 2025

- Vazhdimi i realizimit të Projektit për ndërtimin e objektit për të gjitha OPSH-të, financuar nga Projekti KSV/017 “Përkrahja për sektorin e shëndetësisë” dhe OPSH-të. Në këtë fazë sipas procedurave administrative dhe hapave të planifikuara deri në përfundim të projektit, kemi pranuar lejen për kushtet ndërtimore nga komuna e Prishtinës, është bërë plani detal i objektit nga arkitektët dhe gjithahtu OPSH-të së bashku me projektin Luxembourg Development kanë filluar procedurat e prokurimit për fillimin e punimeve. Hapi i ardhshëm i projektit është përfundimi i procedurave të prokurimit të përzgjedhjes së operatorit ekonomik për ndërtimin e objektit të përbashkët për OPSH-të si dhe pas procedurave administrative fillimi i punime për ndërtim.
- Botimi i numrave në vazhdimësi të “Revistës Mjeku”.
- Vazhdimi i zbatimit të projekteve për profilizim jashtë vendit, bazuar në marrëveshjen mes OMK-së dhe SHSKUK.
- Organizimi i zgjedhjeve për legjislaturën e IV-të të OMK-së.